



# **Masat e marra nga Qeveria shqiptare dhe institucione të tjera publike për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19**

**3 Prill 2020**

# Shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore



- Është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (24.03.2020).
- Në masën që është e nevojshme ruajtja e shëndetit të shtetasve, kufizohen të drejtat e mëposhtme të garantuara nga Kushtetuta:
  - Paprekshmëria e banesës (neni 37)
  - Zgjedhja e vendbanimit, lëvizja e lirë në territorin shqiptar, dhe dalja jashtë vendit (neni 38)
  - E drejta e pronës private: shpronësimet dhe kufizimet e barazvlefshme (neni 41, pika 4)
  - E drejta e punës (neni 49)
  - E drejta e grevës (neni 51)
- Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile është organi më i lartë për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe subjekteve private, si dhe të burimeve financiare dhe materiale për përballimin e fatkeqësisë natyrore.
- Për përballimin dhe lehtësimin e fatkeqësisë natyrore, merren masa të jashtëzakonshme nga institucionet publike, strukturat operationale të mbrojtjes civile, subjektet private dhe shtetasit.

# Tregtia dhe shërbimet (të përgjithshme)

---

- Janë të hapura farmacitë dhe të gjitha llojet e dyqaneve që shesin ushqime.
- Ndalohet eksporti i barnave dhe pajisjeve mjekësore jashtë Republikës së Shqipërisë.
- Kabinetet/ klinikat dentare në të gjithë vendin mbyllen deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.
- Rastet e urgjencave stomatologjike të trajtohen në klinikën stomatologjike Universitare pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe në institucionet stomatologjike publike që do të funksionojnë vetëm për shërbimin e urgjencës stomatologjike.

# Masa ndëshkuese



	<b>Masë financiare</b>	<b>Pezullim/ndalim aktiviteti</b>	<b>Të tjera</b>
Subjektet të cilët eksportojnë barna/ pajisje mjekësore nga Republika e Shqipërisë pa autorizim e Min. të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	5 000 000 (pesë milionë) lekë	Në rast përsëritjeje, ndalimi i eksportit të barnave/pajisjeve mjekësore deri në 6 muaj	Krahas masës financiare, sekuestrohet e gjithë sasia e barnave/ pajisjeve mjekësore
Mosofrimi i shërbimeve nga farmacitë, tregtuesit me shumicë të barnave dhe prodhuesit e barnave, duke zbatuar kriteret e sigurise te percaktuara	10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për tregtuesit me shumicë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tregtuesit me pakicë	Në rast përsëritjeje, mbyllet e veprimtarisë për një periudhë 3 vjeççare	Në rast përsëritjeje bllokohet e gjithë sasia e mallit

	<b>Masë financiare</b>	<b>Pezullim/ndalim aktiviteti</b>	<b>Të tjera</b>
Mosofrimi i shërbimeve nga subjektet/ individët që tregtojnë produkte ushqimore, me shumicë apo pakicë duke zbatuar kriteret e sigurisë të përcaktuara	10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për tregtuesit me shumicë  50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për tregtuesit me pakicë	Në rast përsëritjeje, mbylljen e veprimtarisë për një periudhë 3 vjeçare	Në rast përsëritjeje bllokohet e gjithë sasia e mallit
Rritja e çmimit të shitjes, së mallrave, produkteve ushqimore, barnave pajisjeve mjekësore shërbimeve, dhe produkteve sezonale, (kur nuk vjen si pasojë e rritjes së çmimit nga importi i tyre), krahasuar me çmimin e tyre në muajt/ vitin paraardhës nga data e hyrjes në fuqi të aktit normativ	5 000 000 (pesë milionë) lekë për tregtuesit me shumicë  100 000 (njëqind mijë) lekë për tregtuesit me pakicë	Në rast përsëritjeje, mbylljen e veprimtarisë për një periudhë 6 mujore	

# Masa ndëshkuese të shtuara dhe/ose të ndryshuara në Ligjin nr. 15/2016

	<b>Masë financiare</b>	<b>Pezullim/ndalim aktiviteti</b>
Mosmarrja e masave të përgjithshme, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat “a”, b, c, ç, d, dh, e, f të nenit 6 të këtij ligji	Nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë  Deri në 700 000 (shtatëqind mijë)	Në rast përsëritjeje, me mbylljen e veprimtarisë
Refuzimi për vendosjen nën mbikqyrje shëndetësore sipas përcaktimeve të nenit 17 të këtij ligji	100 000 (njëqind mijë) lekë për personin, objekt i mbikëqyrjes shëndetësore  700 000 (shtatëqind mijë) lekë për punëdhënësin e tij	

Ligji nr. 15/2016 “ Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”

<https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligj-nr.-15-dt.-10.3.2016-1.pdf>

# Shërbimet

---

- Ambientet që ofrojnë shërbime në lokale nate mbyllen deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.
- Ambientet e mbyllura të dedikuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve, aktivitetet në palestra, qendra sportive, pishina, qendra interneti, qendra kulturore, sociale dhe argëtimi mbyllen deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.
- Aktivitetet sportive, sociale, kulturore dhe konferenca, publike dhe jopublike, ndalohen deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.
- Anullohen grumbullimet në vende të mbyllura apo të hapura të tilla si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike.
- Mbyllen parqet publike dhe hapësirat e gjelbërta të rrethuara nga zona urbane deri në një urdhër të dytë.

# Masa Ndëshkuese

<b>Subjektet/ individët</b>	<b>Masë financiare</b>	<b>Pezullim/ndalim aktiviteti</b>	<b>Të tjera</b>
Që organizojnë zhvillimin e aktiviteteve jo/publike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike	5 000 000 (pesë milionë) lekë për organizatorët		Ndalim aktiviteti
Publikë apo privatë, që zhvillojnë aktivitete në ambientet e mbyllura të argëtimit për fëmijë e të rinj, palestrat, qendrat sportive, pishinat, qendrat e internetit, qendra kulturore, që nuk zbatojnë urdhrin për mbylljen e tyre	1 000 000 (një milionë) lekë	Në rast përseritjeje, mbylljen e veprimtarisë për një periudhë 6 mujore	



# Tregtia dhe shërbimet

---

- Baret, restorantet, fast food-et, lokalet që ofrojnë shërbim për klientët në të gjithë vendin mbyllen deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019. Përjashtim bën vetëm shërbimi në banesë (delivery) i cili kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.
- Përdorimi i shërbimeve të bareve dhe restoranteve në strukturat akomoduese vetëm për individët e akomoduar në strukturat akomoduese përkatëse (ndalohej për individët që nuk janë klientë të strukturave akomoduese deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019).
- Organet e shërbimit postar duhet të garantojnë vazhdimësinë e shërbimit, dhe të hartojnë një plan masash për të kufizuar kontaktet e punonjësve me publikun dhe për të shmangur grumbullimin e publikut në sportele apo ambiente të tjera të brendshme.

# Masa Ndëshkuese



	<b>Masë financiare</b>	<b>Pezullim/ndalim aktiviteti</b>
Subjektet/ individët që nuk zbatojnë urdhrat për mbylljen e bareve, lokaleve, restoranteve dhe klubeve	1 000 000 (një milionë) lekë	Në rast përsëritjeje, mbylljen e veprimtarisë për një periudhë 6 mujore
Shërbimet postare që nuk zbatojnë detyrimin për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit, dhe marrjen e masave për të kufizuar kontaktet e punonjësve me publikun dhe shmangien e grumbullimit nëpër sportele apo ambiente të tjera të brendshme	1 000 000 (një milionë) lekë	Në rast përsëritjeje, mbylljen e veprimtarisë për një periudhë 6 mujore

# Tregtia (Pika 1)

---

- Të gjitha subjektet që tregtojnë produkte ushqimore dhe produkte të tjera, me shumicë, të domosdoshme për përballimin e situatës së epidemisë, janë të detyruar të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së shkaktuar nga infeksioni COVID-19.
- Mallrat e blerë, me qëllim përballimin e situatës, në rast kur me përfundimin e situatës së epidemisë nuk janë shitur në tregun e lirë, me kërkesë të subjektit, mund t'i shiten Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, sipas faturës me të cilën këto mallra janë blerë.
- Rregullat dhe procedurat për blerjen e këtyre mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



# Tregtia dhe shërbimet

---

- Nga data 23.3.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore, me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare janë lejuar të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën orare 05:00 – 13:00. Duke filluar nga data 13.4.2020, ndryshohet fasha orare nga 05:00 deri në 17:30.
- Punonjësit e institucioneve financiare, të linjave prodhuese e ushqimore dhe të gjitha aktivitetet e lejuara sipas tabelës bashkëlidhur të këtij urdhri do të lejohen të qarkullojnë vetëm për itinerarin shtëpi-punë.

# KUFIZIMI I LËVIZJEVE



- Udhëtimi ndërkombëtar
- Udhëtimi ndërqytetas
- Udhëtimi brenda qyteteve
- Lëvizja e këmbësorëve

# Udhëtimi ndërkombëtar



- Nga data 15.03.2020, ora 23:59, të gjithë kufinjë tokësorë për udhëtimin e njerëzve me Greqinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut janë të mbyllur për një kohë të pacaktuar. Përfshihet transporti i mallrave, produkteve ushqimore dhe pajisjeve mjekësore.
- Fluturimet drejt dhe nga Italia, Greqia, Britania e Madhe, janë të mbyllura pa afat. Kufinjë detarë me Italinë dhe Greqinë janë të mbyllur.
- Fluturimet drejt destinacioneve të tjera funksionojnë sipas orareve normale. Për të udhëtuar drejt aeroportit të Rinasit, qytetarët duhet të telefonojnë paraprakisht në numrat 112 dhe 129 për të marrë lejen e udhëtimit me mjetin përkatës.
- Shtetasit që vijnë nga zonat e izoluara të Italisë, duhet të vetëkarantinohen për 14 ditë në banesën e tyre për të parandaluar përhapjen e virusit.
- Shtetasit shqiptarë, të cilët paraqiten në pikat e kalimit kufitar tokësor, që nuk janë rezident në vende të tjera, do të vetëkarantinohen për një periudhë 14-ditore, nën masa të rrepta sigurie , me shpenzimet e tyre, në struktura akomoduese pranë pikave kufitare, të përcaktuara nga Ministria e Brendshme.
- Shtetasit rezidentë në vende të tjera nuk do të lejohen të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

# Udhëtimi ndërkombëtar



- Transporti tokësor dhe detar i mallrave vazhdon normalisht.
- Kompanitë të cilat kryejnë transport ndërkombëtar mallrash të dorëzojnë listën e drejtuesve të automjeteve të cilët kryejnë transport ndërkombëtar në adresën e emailit [transporti@infrastruktura.gov.al](mailto:transporti@infrastruktura.gov.al). Lista duhet të përmbajë emër, atësi, mbiemër, ditëlindje, numër pasaporte dhe numrin e lejes së drejtimit ndërkombëtare.
- Shtetasit italianë që kanë mbetur në Shqipëri duhet të kontaktojnë me ambasadën italiane, e cila po përpiqet të organizojë një fluturim çarter për nxjerrjen e tyre nga Shqipëria.



# Masa ndëshkuese

<b>Masë financiare</b>	<b>Subjektet/ individët</b>	<b>Subjektet/ individët</b>	<b>Subjektet/ individët</b>	<b>Subjektet/ individët</b>
700 000 (shtatëqind mijë) lekë	Shtetasi, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk deklaron ardhjen e tij nga zonat e prekura nga infeksioni COVID-19, të deklaruara nga organet kompetente, vendase ose të huaja apo ndërkombëtare	Shtetasi, i cili hyn nga zonat e prekura në territorin e Republikës së Shqipërisë, që nuk vetëkarantinohet për një periudhë 14-ditore në ambientet e banesës së tij, si një masë parandaluese për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19	Shtetasi, i cili vjen nga zonat e prekura dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm	Shtetasi, i cili ka rezultuar pozitiv dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm

# Udhëtimi ndërqytetas dhe brenda qyteteve

- Kufizohet lëvizja në të gjitha qendrat urbane të Republikës së Shqipërisë për të gjitha kategoritë (këmbësorë, biçikleta, ciklomotor, motomjete dhe mjete) nga data 13.04.2020 ne fashën kohore 17:30-5:00, si dhe cdo fundjavë duke filluar nga e premtja ora 17:30 deri të hënën në orën 05.00.
- Lejohet të kryejnë aktivitetin e tyre vetëm në fashën kohore 05:00 – 17.30, nga data 13.04.2020, pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe shumicë, pikat e tregtisë së barnave, produkteve mjekësore dhe institucionet financiare.
- Lejohet vetëm qarkullimi (autoambulancat dhe automjetet e personelit shëndetësor dhe social dhe shërbimet mbështetëse në strukturat e kujdesit shëndetësor, publike dhe jopublike, personeli i farmacive publike dhe jopublike, personeli që ofron shërbimet e furnizimit me ushqime, medikamente, shërbimet e kateringut, shërbimet postare, zjarrfikëse, funerale, energjisë, ujësjellës kanalizime, shërbimet private të ruajtjes së sigurisë së objekteve, shërbimet aeroportuale dhe personeli i linjave ajrore), duke dërguar pranë adresës së email [policiarrugore@asp.gov.al](mailto:policiarrugore@asp.gov.al) listën e personave të autorizuar.

# Udhëtimi ndërqytetas dhe brenda qyteteve



- Lejohet qarkullimi i automjeteve të personelit të medias, duke paraqitur dokumentin e tyre të punësimit ose kartën e gazetarit.
- Ndalohet me një afat të papërcaktuar qarkullimi në rrugët Tiranë-Durrës, Shkodër-Lezhë, Elbasan-Korçë, Lushnjë-Fier dhe Fier-Vlorë për të gjitha llojet e automjeteve private, përfshi mjetet e transportit të qytetarëve.
- Nga data 15 mars, ndalohet deri në një urdhër të dytë lëvizja e mjeteve të transportit publik për udhëtarët qytetas, ndërqytetas dhe rrethqytetas.
- Ndalohet lëvizjesa me automjete private/shtetërore të punonjësve të administratës publike të institucioneve qendrore dhe atyre vendor, puna e të cilëve lidhet me qëndrimin e tyre në zyrë dhe jo në terren. Përjashtim nga ky rregull bëjnë punonjësit e ministrisë së shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, përfshirë personelin mjekësor dhe infermjeror, punonjësit e Ministrisë së mbrojtjes, Ministrisë së Financave apo të prefekturave dhe bashkive që janë të përfshirë në listën prioritare të firmosur nga titullari I institucionit

# Udhëtimi brenda qyteteve



- Nga data 23.03.2020 do të lejohen të qarkullojnë automjetet që kanë autorizim të veçantë: a) makinat e punonjësve shtetërorë; b) mjetet e transportit të punëtorëve të bizneseve. Për autorizimin e këtyre mjeteve duhet telefonuar në numrat e policisë 069 412 2223; 069 412 2224.
- Çdo ditë lejohet qarkullimi i makinave të pajisura me autorizim të posaçëm nga autoritet kompetente dhe mjetet e transportit të punonjësve në institucionet publike dhe/ose private të cilët lejohen të qarkullojnë në intervalin kohor 05:00 - 17.30.

# Lëvizja e këmbësorëve

- Nga data 30.03.2020 lejohet levizja e këmbësoreve në zonat urbane vetëm për vajtje në: ushqimore/supermarket, farmaci, bankë ose për shërbime të tjera, vetëm për një orë 05:00 -13:00, duke marre autorizim për lëvizje në e-albania.al ose duke dërguar SMS në numrin 55155. Leja kufizohet vetëm për një person të familjes.
- Nga data 13.04.2020 lejohet levizja e këmbësoreve në zonat urbane vetëm për vajtje në: ushqimore/supermarket, farmaci, bankë ose për shërbime të tjera, vetem per nje person te autorizuar per cdo familje. Autorizimi do te jete per nje here ne dite dhe do te kete nje afat prej 90 minutash, gjate fashes orare 05:00-17:30.
- Nga data 15.03.2020 kufizohet levizja në parqe dhe zona të gjelbërta të hapura në zona urbane duke respektuar detyrimin për të mos u grumbulluar në më shumë se 2 persona, të cilët duhet të respektojnë distancën prej jo më pak se 2 metra midis tyre.
- Nga data 16.03.2020, ndalohet lëvizja e këmbësorëve pensionistë në zonat urbane deri në një urdhër të dytë, me përjashtim të rasteve kur kane një autorizim për të lëvizur ose emergjencave shëndetësore.
- Gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, orari i punës për nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të administratës publike/shtetërore është 08:00-13:00
- Punonjësit e institucioneve financiare, të linjave prodhuese e ushqimore dhe të gjitha aktivitetet e lejuara sipas tabelës të publikuar, do të lejohen të qarkullojnë vetëm për itinerarin shtëpi-punë.

<b>Subjektet/ individët</b>	<b>Masë financiare</b>	<b>Bllokim automjeti/ Mjeti lëvizës</b>	<b>Heqje e lejes së drejtimit</b>
Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin për ndalimin e lëvizjes për këmbësorët sipas orareve të përcaktuara,	10 000 (dhjetë mijë) lekë	3 muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë	
Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin për kufizimin e lëvizjeve në parqe dhe zona të gjelbërta të hapura, në zonat urbane, apo mjedise të tjera publike të hapura,	20 000 (njëzet mijë) lekë	3 muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë	
Per individët, te cilët, ne kushtet e shkeljes se ndalimit te qarkullimit, lëvizin me biçikletë, ciklomotorr ose motomjet,		3 muaj të mjetit levizës	
Drejtuesit e automjeteve, të cilët nuk zbatojnë ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit, publik dhe privat, përfshirë automjetet private, në zonat dhe oraret e përcaktuara			3 vite (përfshihen personat e autorizuar)

# Masat mbi organizimin spitalor dhe mjekësor



- Vendoset pasuria e ish-universitetit “Kristal”, me vendndodhje në Mëzez, Tiranë, zona kadastrale 2679 ne dispozicion të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për përballimin e situatës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19. Kjo pasuri do të përshtatet në një strukturë karantine ose spitalore nga Ministria së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Spitalet dhe qendrat shëndetësore duhet të marrin masa për të siguruar mjetet e mbrojtjes personale dhe dezinfektuese në mjediset e tyre dhe për të siguruar kushte për izolimin e pacientëve sipas nevojës dhe rekomandimeve përkatëse të ISHP.
- Caktohet ngritja e karantinës në Spitalin Infektiv sipas kritereve të përcaktuara në Urdhërin përkatës të Ministres përgjegjëse për shëndetësinë.
- Caktohet struktura për ngritjen e karantinës në Durrës.
- Është miratuar “Protokolli i veprimit për personelin e Njesisë së Koordinimit të Urgjencave mjekësore dhe Autoambulancave në terren” dhe “Protokolli 2019-nCoV për personelin mjekësor”

# Masat mbi organizimin spitalor dhe mjekësor

---

- Azhurnohet lista e sëmundjeve infektive të detyrueshme për tu raportuar nga institucionet shëndetësore, përfshirë COVID-19.
- Ndalohet eksporti i barnave dhe i pajisjeve mjekësore në mungesë të autorizimit të posaçëm të lëshuar prej Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Ndalohet grumbullimi i pacientëve në ambiente të brendshme, institucioneve të kujdesit shëndetësor, poliklinika dhe spitale, publike dhe jopublike. Të respektohet distanca prej 1.5 m nga njeriu tek njeriu, dhe midis pacientit dhe operatorit të shërbimit.
- Ndalohet prania e familjarëve dhe të afërmeve shoqëruar në mjediset e konsultave, poliklinikave dhe qendrave shëndetësore.
- Pezullohen deri në përfundim të epidemisë COVID-19: ndërhyrjet kirurgjikale të planifikuara në QSUT, dhe në Spitalin Universitar Shefqet Ndroqi me përjashtim të ndërhyrjeve kirurgjikale si pasoje e patologjive malinje.



# Masat mbi organizimin spitalor dhe mjekësor

---

- Pezullohen deri në përfundim të epidemisë COVID-19:
  - shqyrtimi i ankesave nga komisionet eprorë mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimit Social Shtetëror,
  - funksionimi i Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë,
  - funksionimi i Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar
- Pezullohet ofrimi i shërbimit stomatologjik në klinikat dentare në të gjithë vendin. Përfundim bën vetëm shërbimi i urgjencës stomatologjike, i cili do të ofrohet pranë Klinikës Stomatologjike Universitare në QSUT dhe institucioneve stomatologjike publike.
- Është parashikuar që, me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, të vendosen në funksion të menaxhimit të emergjencës edhe struktura private spitalore, ambulatorë, hoteliere, autoambulancat dhe personeli përkatës, shëndetësor e mbështetës.

<b>Subjektet/ individët</b>	<b>Masë financiare</b>	<b>Pezullim/ndalim aktiviteti</b>	<b>Sekuestrim</b>
Personat që eksportojnë barna dhe pajisje mjekësore	5 000 000 lekë (pesë milionë)		sasia e barnave/pajisjeve mjekësore
Institucionet e kujdesit shëndetësor, private apo publike, të cilat nuk respektojnë ndalimin e grumbullimit të pacientëve dhe distancën prej 1.5m	1 000 000 lekë (një milionë)	Në rast përsëritje, veprimtaria mbyllet për 6 muaj	
Shoqëruesi dhe/ose familjari i pacientit si dhe personi i ngarkuar me zbatimin e ndalimit	500 000 lekë (pesëqind mijë)		
Tregëtuesit e barnave shumicë/pakicë që rrisin cmimet e barnave	5 000 000 lekë (shumice) (pesë milionë) 100 000 (pakicë) (njëqind mijë)	Në rast përsëritje, veprimtaria mbyllet për 6 muaj	
Strukturat private, spitalore, ambulatorë, hoteliere, autoambulancat, dhe personeli përkatës	5 000 000 lekë (pesë milionë)	Në rast përsëritje, veprimtaria mbyllet për 6 muaj	



**Masa për t'u marrë nga struktura të veçanta**

# Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)



Ngarkohet me:

- ❖ Përcaktimin e nivelin të rrezikut dhe depërtimit të COVID-19 në vend.
- ❖ Përforcimin e survejancës për infeksione të rënda respiratore akute dhe pneumoni akute
- ❖ Sigurimin e marrjes së mostrave respiratore (bashkëpunim me spitalet në rang vendi)
- ❖ Përkufizimin e rastit klinik dhe përgatitjen e udhëzimeve për:
  - Survejancën dhe hetimin epidemiologjik,
  - Hetimin e kontakteve,
  - Marrjen dhe transportin e mostrave
  - Kontrollin e infeksionit për rasteve e infektuara
- ❖ Përgatitjen e udhëzimit për menaxhimin e rasteve të infektuara
- ❖ Koordinimi në rang vendor, të veprimeve me Operatorinë e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor



## Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT) dhe Spitali Universitar Shefqet Ndroqi

- ❖ Bashkëpunon me ISHP për përgatitjen e udhëzimit për menaxhimin e rasteve të infektuara;
- ❖ Vlerëson nevojat sipas listave të OBSH (në bashkëpunim me ISHP);
- ❖ Koordinon menaxhimin e pacientëve ndërmjet këtyre strukturave.

# Shërbimet publike



- Institucionet publike shfrytëzojnë maksimalisht shërbimet online dhe platformën e-albania. Në shërbimet për të cilat nevojitet kontakt i afërt me publikun, punonjësit pajisen me mjete mbrojtëse.
- Nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të administratës publike do të punojnë në orarin 08:00 - 13:00. Ata ngarkohen të kryejnë çdo detyrë funksionale që iu ngarkohet nga eprori i drejtpërdrejtë apo titullari i institucionit, e cila mund të përmbushet në kushtet e banesës, nëpërmjet komunikimit telefonik apo të mënyrave të tjera të komunikimit elektronik
- Garantohet vazhdimësia e shërbimit postar, nën kushte sigurie për punonjësit dhe klientët, duke shmangur kontaktin e afërt dhe grumbullimet në sportele.
- Pezullohen deri me 07.04.2020 veprimtaritë dhe shërbimet gjyqësore në të gjitha gjykatat e vendit, përveç çështjeve me natyrë të ngutshme. Në çdo rast, ndaloher prania e publikut në seancë. Komunikimi i publikut me gjykatat mundësohet nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.
- OShEE dhe ujësjellësit ofrojnë shërbime me personel të reduktuar, për t'ju përgjigjur emergjencave të qytetarëve.

# Shërbimet e përkujdesit shoqëror



- Pezullohen vizitat nga të afërm në institucione të përkujdesit shoqëror, përveç se me leje të titullarit të Shërbimit Social Shtetëror.
- Drejtuesit/mjekët e institucioneve të përkujdesit shoqëror publike dhe private të mbajnë kontakte me njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, të monitorojnë situatën shëndetësore të përfituesve të këtyre shërbimeve dhe të raportojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror mbi monitorimin e procesit.
- Merren masa të shtuara higjieno-sanitare dhe dezinfektohen të gjitha ambientet në institucionet e përkujdesit shoqëror.

# Ofrimi i asistencës në banesë për shtresat në nevojë



- Dërgimi i pagesave mujore që subjektet përfitojnë nga programi i mbrojtjes sociale nga sigurimet shoqërore dhe dërgimi i produkteve, ushqimore e joushqimore, minimale, barnave të rimbursueshme dhe atyre me kërkesë, për përballimin e situatës apo në kryerjen e furnizimeve me produktet e mësipërme, për llogari të tyre.
- Shtresa në nevojë:
  - a) personat/familjet, të cilët nuk kanë familjarë të aftë për punë në njësinë administrative ku jetojnë:
    - i. Familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike;
    - ii. Personat me aftësi të kufizuara;
    - iii. Personat, të cilët përfitojnë pension pleqërie.
  - a) personat, të cilët, pavarësisht përbërjes familjare dhe vendndodhjes së saj:
    - i. Familjet/individët në nevojë, të cilët janë të pastrehë;
    - ii. Familjet që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit.



# Ofrimi i asistencës në banesë për shtresat në nevojë: procedura



- Përcaktimi i masës së produkteve, ushqimore dhe joushqimore, minimale, dhe i llojit të ndihmës kryhen me vendim të Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës.
- Prefekurat, bashkitë, me kërkesën e Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës, Shërbimi Social Shtetëror dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të përpilojnë listat e subjekteve përfituese.
- Listat i dërgohen në rrugë elektronike Komisionit Qendror për Ofrimin e Asistencës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Pas verifikimit dhe konfirmimit, prefektët e qarqeve dhe kryetarët e bashkive ngrënë komisionet e mbrojtjes civile. Angazhohen personeli i bashkive dhe prefekturave, shërbimi vullnetar dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë për dërgimin e produkteve, ushqimore dhe joushqimore, te shtresat në nevojë.
- Dërgimi i pagesës mujore kryhet nga shërbimi postar, dhe listat përditësohen çdo javë.

# Tatimet dhe doganat

---

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve orienton tatimpaguesit dhe të gjithë të interesuarit të marrin shërbimet në mënyrë elektronike. Edhe për Doganat, shërbimet ndaj operatorëve ekonomikë kryhen online përse është e mundur.
- Nuk do të ofrohen shërbime për operatorët ekonomikë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Shërbimi i korrespondencës dhe protokollit do të zhvendoset jashtë ambienteve të DPD-së. Zyra e protokollit do të tërheqë korrespondencën çdo ditë në orën 14:00. Është instaluar info-point me të dhënat e kontaktit për çdo drejtori. Numrat e kontaktit info-point janë: **069 244 544 4** nga ora 08:00 – 12:00 dhe **068 444 002 5** nga ora 12:00 – 16:00.
- Pezullohen të gjitha kontrollet e planifikuara në terren nga DPD dhe strukturat e saj, përveç kontrolleve të mbikëqyrjes doganore emergjente. Përrjashtohen nga kjo pikë strukturat e Antikontrabandës, Informacionit dhe Antitrafikut.
- Vijnë procedurat operacionale në zonat dhe Degët Doganore. Ndalohet grumbullimi i përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë në sportele, duhet respektuar distanca e sigurisë prej së paku një metër. Punonjësit pajisen me mjete mbrojtëse.

# Arsimi



- Procesi mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike, mbyllet deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019. Mësimi gjatë kësaj kohe zhvillohet online, sipas udhëzimeve të publikuara në faqen e Ministrisë së Arsimit.
- Çerdhet në të gjithë vendin janë të mbyllura deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.
- Eskursionet mësimore të organizuara prej institucioneve shkollore me destinacion brenda ose jashtë vendit janë të ndaluara deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.
- Ndalimi i procedurave të konkursit për punësim personeli, konkurse shkollimi dhe specializimi deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019.

# Masa ndëshkuese



	<b>Masë financiare</b>	<b>Pezullim/ndalim aktiviteti</b>
Institucionet arsimore, çerdhet dhe kopshtet, publike dhe jopublike, që nuk mbyllin aktivitetin e tyre, te përcaktuar si mësipër	5 000 000 (pesë milionë) lekë për institucionet arsimore, publike/ jopublike  1 000 000 (një milion) lekë për çerdhet dhe kopshtet publike/ jopublike	Në rast përsëritjeje, mbylljen e veprimtarisë për një periudhë 6 mujore
Subjektet dhe individët, publikë apo privat, të cilët lejojnë zhvillimin e aktivitete sportive, sociale, kulturore, eskursioneve mësimore brenda dhe jashtë vendit të organizuara nga institucionet arsimore publike dhe private	1 000 000 (një milion) lekë	Në rast përsëritjeje, mbylljen e veprimtarisë për një periudhë 6 mujore

# Arsimi (tanimë jo te aplikueshme )

---

- Është bërë sigurimi i kushteve higjieno sanitare dhe artikujve higjieno sanitar duke përdorur dezinfektuesit përkatës. Është siguruar higjena personale për fëmijët nxënësit dhe studentët. Është kryer edukimi për higjenën sanitare si dhe është siguruar higjena personale e personelit arsimor.
- Drejtuesit e institucioneve arsimore paraqesin numrin total të mungesave në frekuentim për arsye shëndetësore drejt personelit shëndetësor të institucioneve parashkollore dhe ato arsimore.



# Masat e marra nga institucionet e tjera publike

# Këshilli i Lartë Gjyqësor



KLGG ka pezulluar ushtrimin e veprimtarisë së tij që përfshin:

- ❖ pezullimin e organizimit dhe zhvillimit të mbledhjeve plenare të Këshillit/komisioneve;
- ❖ pezullimin e të gjitha afateve të parashikuara në shpalljet publike të bëra nga KLGJ, nëpërmjet të cilave është bërë hapja e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar; për komandim gjyqtari në Shkollën e Magjistraturës; për komandim gjyqtari në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; për komandim gjyqtaresh në Ministrinë e Drejtësisë;
- ❖ pezullimin e afateve në procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020.

# Banka e Shqipërisë



Këshilli Mbikëqyrës i Bankës ka miratuar ndryshime në rregulloret:

- ❖ “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”
- ❖ “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka”
- ❖ “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”

duke shtuar një dispozitë e përkohshme e cila u krijon lehtësi bankave dhe subjekteve financiare jobanka, si dhe shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre për periudhën mars – maj 2020, që në rastet kur evidentohen paaftësi paguese të kredimmarrësve të mos jenë subjekt i zbatimit të kërkesave të këtyre rregulloreve që lidhen kryesisht me klasifikimin dhe krijimin e fondeve për provigjione. Ndryshimet nuk parashikojnë shpenzime buxhetore dhe kosto shtesë për subjektet.



# Banka e Shqipërisë: riskedulimi i kësteve të kredisë

---

- Masat kanë hyrë në fuqi më 13 mars 2020 dhe zgjasin deri më 31 maj 2020.
- Kredimarrësit individë dhe biznese, gjendja financiare e të cilëve përkeqësohet nga situata aktuale, mund të përfitojnë një shtyrje, deri në 3-muaj, të pagesave të kësteve të kredive të tyre, të marra nga institucionet financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë: banka, jobanka dhe shoqëri kursim-krediti.
- Të gjithë ata kredimarrës, biznese dhe individë, të cilët preken ekonomikisht dhe financiarisht nga kjo situatë, dhe që dëshirojnë të përfitojnë nga kjo lehtësi, duhet të kontaktojnë me institucionin financiar me të cilin kanë marrëdhënien e kreditimit.
- Institucioni financiar në bashkëpunim me kredimarrësin, do të vlerësojë kërkesën dhe, bazuar në specifikat e rastit, do të ofrojë edhe zgjidhjen përkatëse.
- Kredimarrësit, aftësia paguese e të cilëve nuk preket apo dëmtohet nga kjo situatë duhet të vijojnë normalisht shlyerjen e detyrimeve.

# Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

---

Shtyhet pa afat deri në një urdhër të dytë afati i dorëzimit të deklaratave të interesave private:

- ❖ “Periodik/Vjetor 2019”, nga zyrtarët/subjektet deklarues dhe personat e lidhur (afati i zakonshëm 31 mars)
- ❖ Para Fillimit të Detyrës” dhe “Pas Largimit nga Funkioni”, nga zyrtarët/subjektet deklarues

sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

Autoritetet Përgjegjëse për Parandalimin e Konfliktit të Interesit pranë institucioneve publike, marrin të gjitha masat për njoftimin e zyrtarëve në institucionet përkatëse, si dhe në ato të varësisë.

# Dhoma Kombëtare e Avokatisë



Pezullohet mësimdhënia për periudhën 10 mars 2020 deri në datën 3 prill 2020 për asistent avokatët që janë duke ndjekur programin e trajnimit fillestar pranë Shkollës së Avokatisë së Shqipërisë.

(Njoftim datë 9.3.2020)

# Avokati i Popullit



Ankesat e qytetarëve duhet të dërgohen vetëm nëpërmjet postës zyrtare ose në postën elektronike në adresën [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)

# Autoriteti i Mediave Audiovizive



- Transmetimi i spotit sensibilizues dhe informues
- Subjektet audiovizive të kujdesen me përgjegjësi maksimale për personelin brenda mjediseve të redaksive dhe studiove të regjistrimit dhe transmetimit.
- Ndalohet prezenca e publikut në programe televizive direkte ose të regjistruara.
- Në formatet informative apo forum nuk duhet të ketë më shumë se 2 persona të pranishëm, duke respektuar distancat e sigurisë. Rekomandohen lidhjet direkte, në distancë.
- Gjatë raportimit dhe mbulimit të zhvillimeve në terren, redaksitë audio dhe audiovizive duhet të marrin parasysh shëndetin e personelit gazetaresk dhe mbështetës.
- Nga data 12.3.2020, AMA monitoron transmetimet audiovizive për rastet e evidentuara të neglizhencave apo shkeljeve të kërkesave të mësipërme, duke filluar procedura administrative.

# Komisioni i Prokurimit Publik



Komisioni i Prokurimit Publik ka njoftuar operatorët ekonomikë për marrjen elektronikisht të faturës për arkëtim të pagesës së ankesës, si dhe dorëzimin në rrugë elektronike të skanuar të ankesave të tyre, për të vijuar më tej me pagesat në bankat e nivelit të dytë, deri me datë 03.04.2020. Dorëzimi i ankesave nga operatorët ekonomikë si dhe dorëzimi i informacioneve për procedurat e ankimuar nga autoritetet kontraktore, do të paraqitet përveç formës shkresore, edhe në formatin CD.

# Agjencia e Blerjeve të Përqendruara

---


- Janë pezulluar të gjitha procedurat e monitorimit të zbatimit të kontratave nga autoritetet kontraktore, të parashikuara për t'u kryer deri në fund të muajit Mars 2020, për t'u zhvilluar në një afat të dytë.
- Vazhdon veprimtaria për publikimin e procedurave të domosdoshme apo emergjente, hapjen dhe vlerësimin e ofertave, shqyrtimin e ankesave, shpalljen e fituesve dhe dërgimin e njoftimeve për lidhje kontrate në autoritetet kontraktore, me qëllim plotësimin e nevojave emergjente apo të domosdoshme të tyre, nëpërmjet punës në distancë nga shtëpia, në platformën elektronike të prokurimit [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), si dhe duke caktuar të gatshëm për të dalë fizikisht në punë një numer të kufizuar punonjësish, nëse do të jetë e nevojshme.
- ABP-ja ka detyrimin të përditësojë çdo ditë listën e bizneseve që shprehin disponibilitetin e tyre, nëse kanë mallra/shërbime të leverdisshme për lidhjen e kontratave publike në zbatim të parashikimeve të aktit normativ nr.14, datë 11.04.2020.

# Departamenti i Administratës Publike



- Janë pezulluar të gjitha procedurat e rekrutimit në shërbimin civil të menaxhuara nga DAP për institucionet e administratës shtetërore.
- Rritja e masave higjieno-sanitare dhe dezinfektimi i të gjitha ambienteve të godinës.





# **Qëndrimi i përkohshëm në shtëpi i të dënuarve (Akt Normativ nr.7) 23.03.2020**

Përcaktimi i kushteve dhe i kriterëve për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi të të dënuarve, si një leje e veçantë, gjatë kohëzgjatjes së epidemisë së shkaktuar nga

COVID-19

# Kriteret e përfitimit të lejes së veçantë



I dënuari mund të përfitojë leje të veçantë qëndrimi të përkohshëm në shtëpi për një periudhë 3-mujore, në rast se në datën e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ:

- Është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe i ka mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë deri në tre vjet burgim;
- Është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe përmbush të gjitha kushtet e mëposhtme:
  - I ka mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë deri në pesë vjet burgim;
  - Është baras ose mbi moshën 60 vjeç;
  - Vuan nga një sëmundje kronike e rrezikshme për jetën;
  - Nuk është në kriteret ndaluese të parashikuara në nenin 5, të këtij akti normativ.

Periudha e qëndrimit të përkohshëm në shtëpi përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.

# Kriteret ndaluese për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi



Nuk përfitojnë leje të veçantë për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi personat e dënuar për:

- Krime kundër njerëzimit
- Krime kundër jetës, të kryera me dashje
- Veprat penale të kryera me dashje, kundër shëndetit
- Krime seksuale
- Veprat penale kundër lirisë së personit
- Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes
- Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike
- Krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues
- Krime kundër autoritetit të shtetit
- Vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale

# Kriteret ndaluese për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi



Nuk përfiton leje të veçantë për qëndrimin e përkohshëm në shtëpi, i dënuari, i cili, është në kushtet e mëposhtme:

- Është në hetim ose është dënuar për një vepër tjetër penale gjatë qëndrimit në institucion;
- Ka marrë një masë disiplinore gjatë gjashtë muajve të fundit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për trajtimin e të dënuarve;
- Paraqet rrezikshmëri shoqërore ose ka pasoja për rendin dhe sigurinë publike;
- Nuk ka një banesë ose familjarët e tij nuk japin pëlqimin për të qëndruar në të njëjtën banesë, gjatë periudhës së qëndrimit të përkohshëm në shtëpi.

# Detyrimet gjatë qëndrimit të përkohshëm në shtëpi



I dënuari është i detyruar që:

- të mos largohet nga shtëpia, pa miratimin paraprak të strukturës vendore të Policisë së Shtetit;
- të mbajë kontakte të rregullta me strukturën vendore të Policisë së Shtetit, në bashkinë ku ka vendbanimin;
- të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë;
- të zbatojë masat e veçanta për parandalimin e sëmundjeve infektive të miratuara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore;
- të paraqitet, në datën e përfundimit të periudhës qëndrimit të përkohshëm në shtëpi, në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku po vuante dënimin.

# Detyrimet gjatë qëndrimit të përkohshëm në shtëpi

---

- Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozimin e Policisë së Shtetit, të prokurorit përkatës, të strukturave përgjegjëse për parandalimin e sëmundjeve infektive ose çdo organi tjetër publik, mund të shfuqizojë lejen e veçantë me qëndrimin të përkohshëm në shtëpi, në rast se i dënuari nuk zbaton detyrimet, ose kur i dënuari kryen një vepër tjetër penale.
- Me marrjen e njoftimit të shfuqizimit të lejes së veçantë me qëndrim të përkohshëm në shtëpi, i dënuari kthehet në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku po vuante dënimin.
- Koha e qëndrimit në shtëpi e të dënuarit, të cilit i është shfuqizuar leja e veçantë, nuk njihet si periudhë e vuajtjes së dënimit.

# Detyrimi për t'u kthyer në përfundim të periudhës së qëndrimit të përkohshëm në shtëpi

- Moskthimi në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, pas përfundimit të periudhës së qëndrimit të përkohshëm në shtëpi ose pas shfuqizimit të saj, përbën shkak për fillimin e procedimit penal, sipas parashikimeve të nenit 323, të Kodit Penal.
- Pas përfundimit të periudhës së qëndrimit të përkohshëm, përpara pranimit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, i dënuari i nënshtrohet analizave të nevojshme mjekësore për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

# VKM nr. 249 “Për detajimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit ANTICOID-19”

---

Fondi antiCovid-19, prej 2 500 milionë lekësh, përdoret nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas detajimeve të mëposhtme:

- Në masën 500 milionë lekë, në programin “Shërbimet e kujdesit dytësor”, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
- Në masën 150 milionë lekë, në programin “Shërbimet e shëndetit publik”, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
- Në masën 50 milionë lekë, në programin “Shërbimi Kombëtar i Urgjencës”, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
- Në masën 800 milionë lekë, në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, në kategorinë e shpenzimeve korrente;
- Në masën 1 000 milionë lekë, në programin “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, në kategorinë e shpenzimeve kapitale.



## **Akti normativ nr. 9 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”**

---

- Seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, të planifikuara pranë të gjitha gjykatave, shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.
- Nga data e hyrjes së fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normativ. Kur afatet fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.
- Gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga përhapja e COVID-19 dhe me synimin për të kufizuar efektet negative në veprimtarinë gjyqësore, këshillat si dhe organet e administrimit gjyqësor të çdo gjykate miratojnë masa organizative specifike për zhvillimin e proceseve gjyqësore, të nevojshme për të shmangur grumbullimet në ambientet e gjykatave dhe brenda sallave gjyqësore, si dhe kontaktet e ngushta ndërmjet individëve.
- Pjesëmarrja e personave të dënuar apo me masë sigurimi “arrest në burg”, si dhe e përfaqësuesve ligjorë të tyre, në të gjitha seancat gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë, sigurohet, atje ku është e mundur, nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë.

## **Akti normativ nr. 10 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”**

---

Për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi fitimin, në vitin 2020, afatet e deklarimit dhe të pagesës janë, si më poshtë vijon:

- a) Bilanci kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo e dhënë tjetër e përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, në zbatim të këtij ligji, dorëzohet brenda orma 31 korrik 2020;
- b) Për tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, tatimi i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme, pakësuar me shumat e përcaktuara sipas nenit 37, të këtij ligji, dhe me parapagimet e bëra gjatë periudhës tatimore, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, brenda gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2020;
- c) Për tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, këstet e tatim-fitimit të tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2020, parapagohen në llogarinë e organeve tatimore, brenda datës 31 dhjetor 2020. Këstet paraprake të tatimit mbi fitimin, të tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2020, parapagohen në llogarinë e organeve tatimore, brenda datës 31 dhjetor 2020.”.

## Mbi qirate: Vendim nr. 5 i Komitetit ndërministror të Emergjencave Civile

Qiramarrësit individë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës, që kanë kontratë pune por e kanë pezulluar/zgjidhur atë si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Qiramarrësit studentë, të cilët kanë kontratë qiraje për banesë apo çdo dokument tjetër që vërteton marrëdhënien kontraktore qiradhënës–qiramarrës nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Qiramarrësit persona fizikë/juridikë me të ardhura deri në 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, dhe e kanë ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID–19, nuk do ta paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020.

Detyrimi i prapambetur i këtyre dy muajve do të paguhet nga qiramarrësi, pas muajit maj 2020. Për ato kontrata që përfundojnë përpara afatit 31 maj 2020, detyrimi i prapambetur do të paguhet nga qiramarrësi brenda tre muajve pas datës 31 maj 2020.

Qiradhënësit, të cilët nuk e zbatojnë këtë pikë, dënohen me gjobë në masën e pesëfishit të qirasë mujore përkatëse.

## Vendim nr. 4 i Komitetit ndërministror të Emergjencave Civile:



**“Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”**

Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se tre muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.

Nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, të bordeve apo të komisioneve të institucioneve të administratës shtetërore, të institucioneve publike të arsimit të lartë, të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, për periudhën nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, por jo më shumë se tre muaj, nuk e përfitojnë shpërblimin mujor përkatës.

Përfshihen nga zbatimi i pikës 2, të këtij vendimi, nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, bordeve apo komisioneve të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

## Akt normativ nr. 13

Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19

- Pezullohen afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të përmbartuesit gjyqësor shtetëror apo privat, ndërmjetësit dhe administratorit në procedurat e falimentimit. Kur afatet për kryerjen e veprimeve procedurale sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.
- Organet e shërbimit përmbartimor shtetëror dhe privat, të ndërmjetësve dhe administratorëve të falimentimit, në të gjitha rastet, marrin masa organizative të posaçme për të shmangur grumbullimet, kontaktet e ngushta ndërmjet individëve, si dhe praninë e publikut në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të përmbartuesit gjyqësor, ndërmjetësit dhe administratorit të falimentimit.

**“Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”**

Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe ministrat, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se tre muaj, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.

Nëpunësit e institucioneve të administratës shtetërore, të cilët janë anëtarë të këshillave, të bordeve apo të komisioneve të institucioneve të administratës shtetërore, të institucioneve publike të arsimit të lartë, të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare me kapital mbi 50% shtetëror, për periudhën nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, por jo më shumë se tre muaj, nuk e përfitojnë shpërblimin mujor përkatës.

## Miratim kontratash (prokurim i drejtëpërdrejtë) për blerje pajisje mjekësore në kuadër të masave kundër COVID-19

---

- VKM nr. 272, datë 3.4.2020 “Për miratimin e kontratës për lotin 1 me objekt “Blerje kite për laboratorin mikrobiologjik për realizimin e RT-PCR të përshtatshëm për t’u përdorur për pajisjen e Existation të firmës BIONEER ose ekuivalent” për QSUT-në” (MSHMS)
- VKM nr. 273, datë 3.4.2020 “Për miratimin e kontratës për lotin 2 me objekt “Trajtim dhe asgjësim të mbetjeve që dalin nga shërbimet ku marrin trajtim pacientët me COVID-19 për QSUT”” (MSHMS)
- VKM nr.274, datë 3.4.2020 “Për miratimin e kontratës me objekt “Furnizim vendosje respiratorë me dy modalitete për adultë dhe moshë pediatrike për COVID-19”” (MSHMS)
- VKM nr.276, datë 6.4.2020 “Për miratimin e kontratës me objekt “Blerje materiale mjekësore në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19”” (MD)

## Miratimi i garancisë shtetërore të huasë me banka të nivelit të dytë (VKM nr. 277, datë 6.4.2020)

---

- Miratimi i linjës së garancisë shtetërore, në vlerën 11 000 000 000 (njëmbëdhjetë miliard) lekë, në favor të bankave të nivelit të dytë, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Skema e garancisë që do të mundësojë huadhënien për të përballuar pagat e tregtarëve ose të shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është mbyllur ose është ndikuar me ulje të xhiros, si pasojë e vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhrave të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19.
- Skema e garancisë, nuk përfshin tregtarët ose shoqëritë tregtare, të cilat para miratimit të këtij vendimi janë subjekt i përfitimit nga skema e subvencionimit të pagës sipas vendimit nr.254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave.
- Marrëveshjet e garancisë janë sipas kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes tip që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe nënshkruhen me secilën bankë nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.
- Struktura e posaçme ndërinstytucionale, e cila do të monitorojë, shqyrtojë dhe raportojë, periodikisht, pranë Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë në lidhje me ecurinë e garancisë shtetërore, do të miratohet me urdhër të Kryeministrit.



## **Vendim i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile nr.6, datë 9.4.2020 “Për detajimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike”**

---

- Autorizon ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kryerjen e detajimit të aktiviteteve të përcaktuara në tabelën bashkëlidhur urdhrin nr.193, datë 20.3.2020, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat detajohen sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike dhe miratohen sipas listës bashkëlidhur këtij urdhri.
- Aktivitetet e lejuara, sipas tabelës bashkëlidhur urdhrin nr.193, datë 20.3.2020, e ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm sipas udhëzimeve të miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik, për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

## Vendim i Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile nr.7, datë 9.4.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.254, datë 27.3.2020

- I propozon Këshillit të Ministrave ndryshimin e vendimit nr.254, datë 27.3.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.254, datë 27.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milion lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”, me qëllim zgjerimin e kategorisë së përfituesve të ndihmes financiare.

## Vendim nr.284, datë 10.04.2020, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.254, datë 27.3.2020

- Aplikimi për të përfituar ndihmë financiare bëhet nga subjekti i të vetëpunësuarit/të punësuarit. Individët, të cilët janë në më tepër se në një listëpagesë, kur të dy aktivitetet janë të mbyllur si pasojë e masave shtrenguese, përfitojnë si ndihmë financiare vetëm një pagë minimale.
- Në rastin kur vetëm një prej aktiviteteve rezulton i lejuar, individi, i cili është në më tepër se në një listëpagesë, nuk e përfiton ndihmën financiare të pagës minimale.
- Përfituesit e ndihmës financiare janë individët e vetëpunësuar/punësuar në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milion) lekë, ku bëjnë pjesë kategoritë e mëposhtme:
  - a) Personat fizikë të vetëpunësuar;
  - b) Punonjësit e papaguar të familjes të personit fizik tregtar;
  - c) Të punësuarit në personat fizikë tregtarë;
  - d) Të punësuarit në personat juridikë.
- Nuk përfitojnë ndihmë financiare individët e vetëpunësuar/punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë.

## Vendim i Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile nr. 8, datë 11.4.2020

- Cakton z. Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm, me detyrën e të deleguarit të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile në Qarkun e Shkodrës.
- I deleguari i KNEC-së për Qarkun e Shkodrës për çështjet operacionale, drejton dhe koordinon, në nivel qendror, strukturat operacionale për përballimin e pasojave të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore në Qarkun e Shkodrës dhe ngarkohet me këto detyra:
  - a) Të drejtojë dhe të bashkërendojë të gjithë veprimtarinë e institucioneve dhe të strukturave të mbrojtjes civile në Qarkun e Shkodrës;
  - b) Të përcaktojë mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale në Qarkun e Shkodrës;
  - c) Të marrë vendime për përballimin e fatkeqësisë natyrore në Qarkun e Shkodrës;
  - d) Të kryejë çdo detyrë tjetër që buron nga ligji nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, si dhe detyra të veçanta të caktuara nga KNEC-ja apo strukturat kompetente shtetërore.
- Të gjitha aktet e nxjerra në zbatim të detyrave, të përcaktuara në këtë vendim, miratohen nga KNEC-ja.
- I deleguari për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore asistohet nga stafe teknike nga struktura që ai drejton.
- Të gjithë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, enteve publike dhe atyre private, të angazhuar në këtë situatë të fatkeqësisë natyrore në Qarkun e Shkodrës, janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e të deleguarit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore.

## **Akt normativ Nr. 14, datë 11.4.2020**

**“Për disa ndryshime dhe shtesa në Aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020”**

**“Neni 3, Masa të veçanta administrative (shtyrja e pagesës së qirasë)”**

- Janë përfshirë në kategorinë e personave fizikë dhe juridikë, të cilët nuk do të paguajnë detyrimin e qirasë për dy muaj, prill dhe maj 2020, të gjithë qiramarrësit, persona fizikë/juridikë, me të ardhura deri në 14 000 000 (katërbëdhjetë milionë) lekë në vit, të cilët kanë kontratë noteriale qiraje për zhvillimin e aktivitetit të tyre ekonomik, të nënshkruar përpara shpalljes së gjendjes së epidemisë, pavarësisht nëse e kanë të lejuar apo të ndaluar aktivitetin si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga COVID-19.

**Akt normativ i Nr. 14, datë 11.4.2020**  
**“Për disa ndryshime dhe shtesa në Aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020”**  
**“Kontratat publike për furnizimin me mallra emergjente dhe bazike nga biznesi i përpunimit aktiv”**

---

- Përcakton kushtet për kryerjen e procedurave të prokurimit me negociim, pa shpallje papaprake të njoftimit dhe të lidhjes së kontratave të furnizimit për mallra, për përballimin e situates së krijuar nga epidemia e shkaktuar nga COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, nga ana e autoriteteve kontraktore të cilat do të përcaktohen me VKM, me operatorët ekonomikë të referuar si “biznesi i përpunimit aktiv”, sipas parashikimeve të Kodit Doganor.
- Bizneset e përpunimit aktiv që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë akt normativ, shprehin disponibilitetin e tyre pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara (ABP).
- Autoritetet kontraktore do të negociojnë vetëm me operatorët e listuar në ABP, sipas mallrave/shërbimeve që duan të prokurojnë.
- ABP-ja ka detyrimin të përditësojë çdo ditë listën e bizneseve që shprehin disponibilitetin e tyre.
- Nëse nevoja nuk mund të plotësohet nga këta operatorë, autoritetet kontraktore mund t'i drejtohen operatorëve të tjerë ekonomikë për përmbushjen e kërkesës për këto mallra, sipas procedurës me negociim, pa shpallje papaprake të njoftimit.
- Përfshihen nga zbatimi i rregullit të përcaktuar në këtë akt normativ të gjitha procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit.